



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 1168 prot.

Himarë, më 18.06.2025

NJOFTIM

“PËR TË PASUR NJË HIMARË TE PASTËR”

Bazuar në ligjin Nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor” dhe VKB Himarë Nr.7 datë 11.02.2025 “Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2025 dhe planit të veprimit përkatës”.

Duke synuar sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar pengesat dhe bllokimet si rrjedhojë e qarkullimit të rënduar gjatë sezonit turistik dhe mbi të gjitha një ambjent të pastër dhe mikpritës.

Me qëllim heqjen e mbetjeve urbane dhe të ngurta nga operatorët kontraktorë që kryejnë shërbimin e “Planit të menaxhimit të mbetjeve urbane” të cilët do të kryejnë këtë shërbim në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë 2 herë nga ora 06⁰⁰-20⁰⁰ dhe në zonat bregdetare turistike një orar shtesë nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit në orën 20⁰⁰-06⁰⁰.

Njoftohen të gjitha subjektet që orari i hedhjes së mbetjeve në kontenierë nga subjektet do të jetë ora :00⁰⁰ deri 02⁰⁰
06⁰⁰ deri 08⁰⁰
15⁰⁰ deri 17⁰⁰

Të gjitha subjektet që hedhin mbetje në kontenierë mbas orarit të njoftimit do të kenë penalitete sipas ligjit në fuqi.

Shënim: Për informacion dhe ankesa:

Për operatotin “Alko Impex Construction” sh.p.k; Përparim Fisniku tel. 0695529297

Për operatorin “Rej” sh.p.k; Ardian Hoti tel. 0688100991

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë; Themistokli Foto tel. 0696952708

KRYETARI
VANGJEL TAVO